



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit**

### **Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi TM4-2018 (2015=100)**



## Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës, përkatësisht Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, ka filluar të grumbullojë të dhëna për çmimet e prodhimeve bujqësore që nga nëntori i vitit 2003. Në fillim, numri i artikujve ishte i kufizuar. Me ndërrimin e vitit bazik nga viti 2003 në vitin bazik 2005, çmimet janë grumbulluar për 64 prodhime të ndryshme bujqësore. Kurse, me ndërrimin e vitit bazik 2005 në 2010, janë grumbulluar çmimet për 67 prodhime bujqësore. Aktualisht, me ndërrimin e vitit bazik nga 2010 në vitin bazik 2015, çmimet grumbullohen për 71 prodhime të ndryshme bujqësore. Qëllimi i indeksit të prodhimeve bujqësore është matja e lëvizjeve të çmimeve për prodhimet e shitura nga fermeri. Plani për të ardhmen është që të rritet numri i produkteve. Si plotësim i indeksit të prodhimeve është edhe indeksi i çmimeve të inputeve.

Ky është publikimi i pesëdhjetë e dytë (52-të) mbi indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore dhe çmimeve mesatare absolute të prodhimeve bujqësore, i përgatitur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Në këtë publikim, indeksi i çmimeve të prodhimeve bujqësore është paraqitur për disa prodhime kryesore bujqësore.

ASK-ja falënderon Agjencionin Ndërkombëtar Suedez për Zhvillim dhe Kooperim (SIDA) për mbështetjen e tyre për ndërtimin e sistemit të statistikave agromonetare. ASK-ja, gjithashtu falënderon të gjithë bashkëpunëtorët e zyrave rajonale të ASK për bashkëpunim, bashkëpunëtorët e tjerë (respondentët) e pikave-vendeve të grumbullimit të çmimeve, si: fermat bujqësore, ndërmarrjet industriale, tregtare etj.

Në veçanti, ASK-ja falënderon ekspertët suedezë të statistikave të çmimeve, z. Anders Grönvall dhe të tjerët, që në mënyrë të drejtpërdrejtë a indirekte ndihmuan në finalizimin e këtij publikimi.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet lidhur me këtë publikim mund t'i dërgoni në email adresën e departamentit: **agriculture@ks-gov.net**

Publikimin e përgatitën:

Bajrush Qevani - Drejtor i departamentit,  
Violeta Arifi – Gashi - Shefe e divizionit,  
Kademsha Bajramaga - Zyrtare

Prishtinë, Shkurt 2019

Kryeshef Ekzekutiv i ASK -së,  
Isa Krasniqi

## Lista e shkurtesave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
IÇPB	-	Indeksi i Çmimeve të Produkteve Bujqësore
BE	-	Bashkësia Evropiane
SIDA	-	Agjencioni Ndërkombëtarë i Suedisë për Zhvillim dhe Kooperim
TM4	-	Tremujori i katërt

## Simbolet

. Të pa – aplikueshme

‰ Promil

Në tabelat ku janë dhënë peshat numrat janë rrumbullakuar deri në shifrën e fundit më të afërt për këtë arsye mund të ketë një mospërputhje të lehtë të shumave.

## **P ë r m b a j t j a**

P ë r m b a j t j a.....	3
Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësoreTM4 2015-2018 (2015=100) .....	6
Indeksi mujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore.....	7
Ndryshimet e indeksit mujor të çmimeve të prodhimeve bujqësore .....	8
Çmimet mesatare mujore për disa prodhime bujqësore .....	9
Metodologjia .....	12
Pyetësori.....	14

## Indeksi i çmimeve të prodhimeve bujqësore

Të dhënat e prezantuara në këtë publikim përfshijnë të dhëna për indeksin prej muajit tetor deri në dhjetor të vitit 2018 (2015=100) që mbulon periudhën 2015-2017. Për të bërë krahasime dhe për të vërejtur ndryshimet janë prezantuar të dhëna për tremujoret e katërt(TM4) të viteve 2015-2017 me vitin bazik 2015,( 2015 =100)

ASK-ja ka bërë ndërrimin e vitit bazik të indeksit nga 2010=100 në 2015=100 sipas metodologjisë së Eurostatit.

Në këtë publikim janë grumbulluar çmimet e prodhimeve vendore bujqësore në Kosovë. Grumbullimi i çmimeve është bërë në: treg, ferma dhe vendet të tjera.

Prodhimet, që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale.


Në kuadër të prodhimeve bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë.

Në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve. Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në Euro dhe njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë.


Grafiku 1,2 dhe 3 prezanton indeksin mujor të çmimeve të prodhimeve bujqësore për periudhën janar- dhjetor 2017 dhe për tremujorin e katërt të vitit 2018 për prodhimet bimore dhe blegtorale. Gjithashtu prezanton totalin e prodhimeve bujqësore dhe vitin bazë 2015 = 100.

Në tremujorin e katërt të vitit 2018 indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për (1.49 %) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka rritje për (11.44 %) në tremujorin e tretë të vitit 2018 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Indeksi total i prodhimeve bujqësore ka rritje për (5.92 %) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017.


**Grafiku 1: Indeksi mujor i çmimeve të prodhimeve bimore, janar- dhjetor 2017 dhe tremujori i katërt 2018 , (2015=100)**



**Grafiku 2: Indeksi mujor i çmimeve të prodhimeve blegtorale, janar- dhjetor 2017 dhe tremujori i katërt 2018 , (2015=100)**



**Grafiku 3: Indeksi mujor total i çmimeve të prodhimeve bujqësore, janar- dhjetor 2017 dhe tremujori i katërt 2018 , (2015=100)**



## Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore TM4 2015-2018 (2015=100)

Tabela 1: Indeksi tremujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore TM4 2015 - 2018 (2015 = 100)

Kodi i IÇPB	Përshkrimi	TM4-2015	TM4-2016	TM4-2017	TM4-2018
<b>010000</b>	<b>DRITHËRAT (përfshirë farërat)</b>	<b>98,6</b>	<b>96,0</b>	<b>78,3</b>	<b>83,5</b>
011000	Grurë dhe spelt (spelt = Triticum aestivum spelta)	98,4	95,5	77,1	82,2
011100	Grurë i butë dhe speltë	98,4	95,5	77,1	82,2
012000	Thekërë dhe meslin (meslin =përzjerje gruri dhe thekëre, lloj drithi)	99,8	99,5	102,9	81,7
013000	Elb	102,1	103,2	95,8	84,4
013200	Elb për prodhimin e birrës	102,1	103,2	95,8	84,4
014000	Tërshër dhe perzierje të drithërave verore	100,2	111,1	96,0	84,5
015000	Misër kokërr	101,2	104,0	95,0	106,5
<b>030000</b>	<b>BIMË FORAGJERE</b>	<b>111,3</b>	<b>111,2</b>	<b>112,8</b>	<b>111,5</b>
031000	Misër për ushqim kafshësh	101,6	96,1	95,4	88,1
032000	Kultura tuberoze për ushqim kafshësh (përfshirë panxharin foragjerë)	.	.	.	.
039000	Bimë tjera foragjere	111,7	111,8	113,4	112,4
<b>040000</b>	<b>PERIME DHE PRODUKTE TJERA HORTIKULTURORE</b>	<b>91,2</b>	<b>90,7</b>	<b>94,1</b>	<b>108,5</b>
041000	Perime të freskëta	91,2	90,7	94,1	108,5
041100	Lulelakër	87,0	121,8	90,2	107,6
041200	Domate	120,6	120,6	128,4	142,0
041900	Perime tjera të freskëta	90,4	89,9	93,2	107,5
042000	Bimë dhe lule	.	.	.	.
<b>050000</b>	<b>PATATE (përfshirë farërat)</b>	<b>102,0</b>	<b>90,0</b>	<b>93,6</b>	<b>124,3</b>
051000	Patate për konsum	102,0	90,0	93,6	124,3
<b>060000</b>	<b>PEMË</b>	<b>97,4</b>	<b>97,5</b>	<b>119,4</b>	<b>121,0</b>
061000	Pemë të freskëta pa i përfshirë agrumet dhe rrushin	94,0	113,1	142,8	102,9
061100	Mollë tryeze	100,3	101,8	144,7	112,1
061200	Dardhë tryeze	96,7	116,9	133,5	112,3
061300	Pjeshkë	.	.	.	.
061900	Pemë të freskëta arrë,lajthi,gështenjë dhe fruta të tharë	87,5	118,0	148,3	89,7
062000	Agrume	.	.	.	.
063000	Pemë tropikale	.	.	.	.
064000	Rrush	99,3	89,2	106,7	130,8
<b>100000</b>	<b>PRODHIMI I KULTURAVE BIMORE (010000 gjer në 090000), përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)</b>	<b>97,1</b>	<b>94,7</b>	<b>101,6</b>	<b>113,2</b>
<b>101000</b>	<b>PRODHIMI I KULTURAVE BIMORE (010000 gjer në 090000), pa i përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)</b>	<b>103,7</b>	<b>96,9</b>	<b>95,4</b>	<b>112,3</b>
<b>110000</b>	<b>BLEGTORIA</b>	<b>99,4</b>	<b>97,4</b>	<b>98,1</b>	<b>103,6</b>
111000	Gjedhët	99,2	97,1	96,8	107,8
111100	Gjedhët pa i përfshirë viçat	99,6	97,7	99,0	111,5
111200	Viçat	98,3	95,8	92,2	100,2
112000	Derrat	96,5	97,7	98,5	100,8
113000	Njëthundrakët ( Kuaj,Gomarë,Mushka)	.	.	.	.
114000	Dele dhe dhi	101,5	97,3	99,3	100,0
115000	Shpezët	99,4	98,7	99,7	99,1
115100	Pulat	99,4	98,7	99,7	99,1
115900	Shpezët tjera	99,4	98,7	99,7	99,1
119000	Kafshë tjera	.	.	.	.
<b>120000</b>	<b>PRODHIMET BLEGTORIALE</b>	<b>100,7</b>	<b>103,6</b>	<b>104,0</b>	<b>103,9</b>
121000	Qumësht	98,7	100,1	101,0	100,7
121100	Qumësht lope	98,7	100,1	101,0	100,7
121900	Lloje tjera qumshti	.	.	.	.
122000	Vezë	109,9	122,7	118,4	118,8
129000	Produkte tjera blegtorale	105,2	103,8	109,1	112,1
<b>130000</b>	<b>BLEGTORIA DHE PRODHIMET BLEGTORIALE (110000+120000)</b>	<b>100,3</b>	<b>101,9</b>	<b>102,3</b>	<b>103,9</b>
<b>140000</b>	<b>GJITHSEJ PRODHIMET BUJQËSORE (100000+130000), përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)</b>	<b>98,9</b>	<b>98,7</b>	<b>102,0</b>	<b>108,0</b>
<b>141000</b>	<b>GJITHSEJ PRODHIMET BUJQËSORE (100000+130000), pa përfshirë pemët (060000) dhe perimet (040000)</b>	<b>101,1</b>	<b>100,8</b>	<b>100,9</b>	<b>105,6</b>

**Indeksi mujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore****Tabela 2: Indeksi mujor i çmimeve të prodhimeve bujqësore, tetor - dhjetor 2018 (2015 = 100)**

Kodi i artikullit	Grupet	Peshat		2018		
		%	1000 Euro	Tet	Nën	Dhj
<b>0 1</b>	<b>Drithërat</b>	<b>27</b>	<b>8 940</b>	<b>83,1</b>	<b>83,3</b>	<b>83,4</b>
0 1.1	Grurë	26	8 455	82,2	82,2	82,2
0 1.3	Elb	0	48	83,5	81,8	88,0
0 1.5	Misër	1	364	102,5	108,6	109,2
0 1.9	Drithëra tjera	0	73	80,6	81,9	87,8
<b>0 3</b>	<b>Bimët foragjere</b>	<b>36</b>	<b>11 643</b>	<b>111,3</b>	<b>109,5</b>	<b>114,5</b>
0 3.1	Misër për ushq. kafshëve	1	425	88,2	84,5	91,9
0 3.9	Bimët tjera foragjere	34	11 218	112,2	110,4	115,4
0 3.9.1	Sanë	26	8 493	112,6	110,6	115,6
0 3.9.2	Kashtë	4	1 234	116,9	116,9	121,5
0 3.9.9	Bimët tjera foragjere ;tjera	5	1 491	105,8	104,0	109,4
<b>0 4</b>	<b>Perimet</b>	<b>210</b>	<b>68 778</b>	<b>112,3</b>	<b>102,2</b>	<b>100,4</b>
0 4.1	Perimet e freskëta	210	68 778	112,3	102,2	100,4
0 4.1.2	Domate	31	10 107	142,0		
0 4.1.9	Perimet tjera të freskëta	179	58 671	111,1	102,2	100,4
0 4.1.9	Speca	105	34 293	119,2	138,5	
0 4.1.9.1	Lakër	1	388	108,3	86,6	99,0
0 4.1.9.4	Tranguj	1	429	155,6		
0 4.1.9.6	Qepë	8	2 569	109,5	164,3	219,0
0 4.1.9.7	Fasulja	49	16 071	93,1	90,5	93,1
0 4.1.9	Shalqi	2	550			
0 4.1.9.9.9	Perimet tjera të freskëta: tjera	13	4 371	80,6	79,4	79,4
<b>0 5</b>	<b>Patatet</b>	<b>62</b>	<b>20 348</b>	<b>124,8</b>	<b>118,4</b>	<b>131,1</b>
<b>0 6</b>	<b>Pemët</b>	<b>87</b>	<b>28 598</b>	<b>112,1</b>	<b>141,8</b>	<b>99,2</b>
0 6.1	Pemët e freskëta	52	16 970	103,7	104,4	99,2
0 6.1.1	Molla	7	2 360	132,7	95,8	85,5
0 6.1.2	Dardha	6	1 963	112,3	112,3	112,3
0 6.1.9	Pemët tjera	39	12 646	87,0	99,6	97,4
0 6.1.9.2	Kumbulla	22	7 221	84,1		
0 6.1.9.4	Frutat e thata,Gështenjë	3	846	98,4	100,6	96,1
0 6.1.9.9	Pemët tjera,të tjera	14	4 579	93,0	95,8	104,8
0 6.4.1	Rrushi	12	3 899	121,2	130,2	
0 6.4.9	Rrush për verëra	24	7 729	114,8	162,0	
<b>10</b>	<b>Prodhimet bimore</b>	<b>423</b>	<b>138 307</b>	<b>112,1</b>	<b>112,2</b>	<b>104,8</b>
<b>11</b>	<b>Blegtoria</b>	<b>162</b>	<b>52 824</b>	<b>103,2</b>	<b>101,4</b>	<b>106,3</b>
11.1	Mëzet dhe Mëshqerra	74	24 125	108,2	104,2	111,2
11.2	Derra	28	9 199	101,3	98,7	102,5
11.4	Dele	46	14 944	97,9	99,0	103,1
11.5	Pula	14	4 556	98,4	99,8	99,1
11,9	Kafshë - tjera	0	-	-	-	-
<b>12</b>	<b>Prodhimet blegtorale</b>	<b>415</b>	<b>135 853</b>	<b>100,4</b>	<b>102,0</b>	<b>109,4</b>
12.1	Qumësht	334	109 198	97,4	99,3	105,4
12.2	Veze	62	20 112	112,1	113,7	130,5
12.9	Prodhimet tjera blegtorale	20	6 543	114,0	111,1	111,1
<b>13</b>	<b>Blegtoria dhe prodhimet blegtorale</b>	<b>577</b>	<b>188 677</b>	<b>101,2</b>	<b>101,8</b>	<b>108,6</b>
<b>14</b>	<b>Totali i prodhimeve bujqësore</b>	<b>1000</b>	<b>326 984</b>	<b>105,8</b>	<b>106,2</b>	<b>107,0</b>



**Ndryshimet e indeksit mujor të çmimeve të prodhimeve bujqësore**
**Tabela 3: Ndryshimet e indeksit mujor të çmimeve të prodhimeve bujqësore, tetor - dhjetor 2017 / 2018 (2015=100)**

Kodi i artikullit	Grupet	Peshat		Tet 17/Tet 18	Nën 17 /Nën	Dhj 17 /Dhj
		%	1000 Euro	Ndrysh. në %	18 Ndrysh. në %	18 Ndrysh. në %
<b>0 1</b>	<b>Drithërat</b>	<b>27</b>	<b>8 940</b>	6,5	6,5	6,7
0 1.1	Grurë	26	8 455	6,7	6,7	6,7
0 1.3	Elb	0	48	-12,9	-14,6	-8,2
0 1.5	Misër	1	364	11,3	11,9	13,3
0 1.9	Drithëra tjera	0	73	-15,1	-20,0	-13,1
<b>0 3</b>	<b>Bimët foragjere</b>	<b>36</b>	<b>11 643</b>	2,5	-2,5	-2,8
0 3.1	Misër për ushq. kafshëve	1	425	-4,6	-13,2	-5,1
0 3.9	Bimët tjera foragjere	34	11 218	2,7	-2,1	-2,8
0 3.9.1	Sanë	26	8 493	2,7	-1,8	-2,5
0 3.9.2	Kashtë	4	1 234	15,1	15,1	7,4
0 3.9.9	Bimët tjera foragjere ;tjera	5	1 491	-6,4	-15,6	-12,0
<b>0 4</b>	<b>Perimet</b>	<b>210</b>	<b>68 778</b>	22,4	2,1	5,4
0 4.1	Perimet e freskëta	210	68 778	22,4	2,1	5,4
0 4.1.2	Domate	31	10 107	.	.	.
0 4.1.9	Perimet tjera të freskëta	179	58 671	23,1	2,1	5,4
0 4.1.9	Speca	105	34 293	.	.	.
0 4.1.9.1	Lakër	1	388	.	.	.
0 4.1.9.4	Tranguj	1	429	.	.	.
0 4.1.9.6	Qepë	8	2 569	25,9	100,0	151,9
0 4.1.9.7	Fasulja	49	16 071	-12,5	-15,0	-5,4
0 4.1.9	Shalqi	2	550	.	.	.
0 4.1.9.9.9	Perimet tjera të freskëta: tjera	13	4 371	-6,9	-1,8	-6,1
<b>0 5</b>	<b>Patatet</b>	<b>62</b>	<b>20 348</b>	28,3	27,3	47,6
<b>0 6</b>	<b>Pemët</b>	<b>87</b>	<b>28 598</b>	-6,8	22,0	-21,6
0 6.1	Pemët e freskëta	52	16 970	-32,3	-20,0	-21,6
0 6.1.1	Molla	7	2 360	.	.	.
0 6.1.2	Dardha	6	1 963	.	.	.
0 6.1.9	Pemët tjera	39	12 646	-44,8	-17,2	-16,3
0 6.1.9.2	Kumbulla	22	7 221	.	.	.
0 6.1.9.4	Frutat e thata,Gështenjë	3	846	-9,4	-15,4	-17,5
0 6.1.9.9	Pemët tjera,të tjera	14	4 579	.	-23,8	.
0 6.4.1	Rrushi	12	3 899	.	.	.
0 6.4.9	Rrush për verëra	24	7 729	.	.	.
<b>10</b>	<b>Prodhimet bimore</b>	<b>423</b>	<b>138 307</b>	13,2	9,9	3,2
<b>11</b>	<b>Blegtoria</b>	<b>162</b>	<b>52 824</b>	5,1	3,0	9,0
11.1	Mëzet dhe Mëshqerra	74	24 125	12,5	6,4	15,3
11.2	Derra	28	9 199	0,9	1,8	4,4
11.4	Dele	46	14 944	-2,0	-0,6	4,7
11.5	Pula	14	4 556	-0,9	-0,4	-0,5
11,9	Kafshë - tjera	-	-	.	.	.
<b>12</b>	<b>Prodhimet blegtorale</b>	<b>415</b>	<b>135 853</b>	-2,3	-1,9	4,1
12.1	Qumësht	334	109 198	-3,3	-1,9	4,2
12.2	Vezë	62	20 112	-1,0	-2,9	4,6
12.9	Prodhimet tjera blegtorale	20	6 543	8,3	0,0	0,0
<b>13</b>	<b>Blegtoria dhe prodhimet blegtorale</b>	<b>577</b>	<b>188 677</b>	-0,3	-0,6	5,4
<b>14</b>	<b>Totali i prodhimeve bujqësore</b>	<b>1 000</b>	<b>326 984</b>	5,3	3,8	4,4

## Çmimet mesatare mujore për disa prodhime bujqësore


Tabela 4: Çmimet mesatare mujore për disa prodhime bujqësore tetor - dhjetor 2018

Kodi i artikullit	Prodhimet	Njësia	2018		
			Tet	Nën	Dhj
01.1.	Gruri <sup>1</sup>	kg	0,16	0,16	0,16
01.3.	Elbi <sup>2</sup>	kg	0,28	0,27	0,29
01.5.	Misri <sup>3</sup>	kg	0,24	0,25	0,26
01.2.	Thekër <sup>4</sup>	kg	0,28	0,28	0,29
01.4.	Tërshërë <sup>5</sup>	kg	0,26	0,26	0,29
03.9.1	Sana <sup>6</sup>	kg	0,16	0,16	0,17
03.9.2	Kashta <sup>7</sup>	kg	0,09	0,09	0,09
03.9.9.	Jongja <sup>8</sup>	kg	0,17	0,17	0,17
05.1.	Patate <sup>9</sup>	kg	0,42	0,40	0,44
04.1.9.1	Lakëra <sup>10</sup>	kg	0,25	0,20	0,23
04.1.9.6	Qepa <sup>11</sup>	kg	0,49	0,73	0,97
04.1.9.9.9	Speca <sup>12</sup>	kg	0,89	.	.
04.1.9.3	Spinaqi <sup>13</sup>	kg	1,21	0,90	.
04.1.9.7	Fasulja <sup>14</sup>	kg	2,50	2,43	2,50
04.1.2	Domatja <sup>15</sup>	kg	.	.	.
04.1.9.4	Tranguj <sup>16</sup>	kg	0,67	.	.
04.1.9.9.9.1	Shalqi <sup>17</sup>	kg	.	.	.
04.1.9.9.9.2	Presh <sup>18</sup>	kg	0,93	0,81	0,96
04.1.9.9.9.3	Hudher <sup>19</sup>	kg	3,21	3,43	3,50
06.1.1	Molla <sup>20</sup>	kg	0,64	0,46	0,41
06.1.2	Dardha <sup>21</sup>	kg	1,10	1,10	1,10
06.1.3	Gështënja <sup>22</sup>	kg	1,93	1,82	2,18
06.1.9	Arra <sup>23</sup>	kg	2,79	2,86	2,71
06.1.4.1	Rrush <sup>24</sup>	kg	1,10	1,18	.
11,1	Mëzet dhe meshqerra <sup>25</sup>	kg	2,53	2,41	2,56
11,2	Derra <sup>26</sup>	kg	2,27	2,21	2,30
11,4	Dele <sup>27</sup>	kg	2,41	2,44	2,54
11,5	Pula ( Fshati) <sup>28</sup>	1 copë	10,14	10,29	10,29
11.5.1	Pula ( ferme) <sup>29</sup>	1 copë	2,02	2,04	1,96
12,1	Qumësht <sup>30</sup>	1 lit	0,29	0,30	0,32
12,9	Mjalt <sup>31</sup>	kg	11,14	10,86	10,86
12,2	Veze <sup>32</sup>	30 copë	2,50	2,54	2,91


<sup>1</sup> ( . ) Tregon se në këta muaj nuk grumbullojmë çmime të prodhimeve bujqësore për këto kultura bujqësore (Lakrë,Speca, Spinaq, Domate,Tranguj, Shalqi, Molla, Dardha, Gështënjë, Rrush)

1– Gruri – prodhim vendor, 2 Elbi – Hibrid 448, 4 Tthekër 5 Tershër, 6 Sana , 7 Kashtë gruri, 8 Jongjë, 9 Patate 10 Lakër- varieteti (Hibrid 4), 11 Qepë klasa e dytë e kualitetit, 12 Speci- Varieteti Sombork, 13 Spinaqi- varieteti Matador, klasa e dytë e kualitetit, 14 Fasulja klasa e dytë e kualitetit, 15 Domate- Varieteti Arleta, 16 Tranguj- Varieteti Cornishon, 17 Shalqi– prodhim vendor, 18 Presh prodhim vendor, 19 Hudhra prodhim vendor, 20 Molla varietet Idaret, 21 Dardha – varieteti autokton , 22 Gështenjë – prodhim vendor , 23 Arra, 24 Rrush-varianti hamburg, 25 Pesha e gjallë për 1kg, për mëzet dhe meshqerra të moshës 18-22 muaj, racë vendore, 26 Pesha e gjallë për 1kg, për derra të moshës 10-12 muaj, racë vendore, 27 Pesha e gjallë për 1kg, për dele racë vendore të moshës jo më të vjetër se 12 muaj, 28 Pula– vendore (të moshës rreth 18 javë Fshati), 29 Pula– vendore (të moshës rreth 18 javë të Fermes ), 30 Qumësht lope –çmimi për 1litër me përbajtje 3.2% yndyrë, 31 Mjaltë – prodhim vendor, 32 Veze çmimi për 30 copë, klasa e parë e kualitetit.


**Grafiku 4: Çmimi mesatar absolut për grurë dhe misër, janar – dhjetor 2017 dhe tremujori i katërt 2018 Euro/kg**




**Grafiku 5: Çmimi mesatar absolut për sanë, jonjë dhe kashtë, janar – dhjetor 2017 dhe tremujori i katërt 2018 Euro/kg**



**Grafiku 6: Çmimi mesatar absolut për patate, domate, speca dhe lakër, janar – dhjetor 2017 dhe tremujori i katërt 2018 Euro/kg**



**Grafiku 7: Çmimi mesatar absolut për mëzet dhe mëshqerra, derra dhe dele si peshë e gjallë, janar – dhjetor 2017 dhe tremujori i katërt 2018 Euro/kg**



## Metodologjia

Çmimet dhe indekset e çmimit në këtë publikim janë kalkuluar sipas standardeve për statistikat e çmimeve të Bashkimit European. Projekti për kalkulimin e këtyre çmimeve dhe indekseve të çmimeve është realizuar brenda projektit për “Përmirësimin e statistikave agromonetare” në bashkëpunim me Statistikat Suedeze dhe me mbështetjen financiare nga Sida (Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar).

Çmimet janë grumbulluar nga nëntori i vitit 2003 dhe janë grumbulluar në shtatë regjione: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjiilan. Çmimet janë grumbulluar çdo muaj rreth datës 15. Që nga fillimi numri i artikujve për të cilët janë grumbulluar çmimet është rritur hap pas hapi. Disa çmime nuk janë në dispozicion për tërë periudhën. Çmimet grumbullohen për 71 prodhime dhe maten çmimet të cilat i marrin fermerët për pjesën e prodhimeve të tyre që janë shitur. Peshat për kalkulimin e indekseve janë kryesisht të bazuara në Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi të vitit 2015, që është vit bazë për indekset (2015=100). Duhet theksuar se peshat, në vlerë ose promil, reflektojnë vetëm pjesën e prodhimeve bujqësore në Kosovë që janë shitur jashtë ekonomive familjare bujqësore. Për disa prodhime vlera e prodhimit total mund të jetë shumë më e lartë se sa reflektohet në pesha.

Sipas standardeve të BE-së, indekset tremujor dhe vjetor supozohet të kalkulohet nga secili shtet anëtarë. Indekset e BE-së në këtë publikim ndjekin metodologjinë e BE-së. Për nevoja nacionale, kalkulohet edhe indeksi mujor. Ky indeks kalkulohet pak më ndryshe se indeksi tremujor. Shkurtimisht, indeksi mujor nuk i përdor peshat mujore në nivelin e agreguar (kur kalkulohet kodi 10, 13 dhe 14). Megjithatë për shumicën e grupeve të kulturave (kodi 01, 03, 04 dhe 06) peshat mujore janë përdorur brenda grupit për të kalkuluar peshat e agreguara të grupit. Në anën tjetër indeksi tremujor çdo kund ka peshë tremujore variabile. Për këtë arsye, indekset mujor dhe tremujor mund të kenë zhvillime me ndryshime të vogla nëse krahasohen. Sidoqoftë, indeksi vjetor i BE-së dhe indeksi vjetor i Kosovës janë plotësisht të njëjtë. Në të dyja rastet, indeksi është kalkuluar si indeks vjetor e peshuar me pesha mujore respektivisht tremujore.

Peshat totale, peshat tremujore dhe peshat mujore janë fikse gjatë periudhës bazë. Të gjitha reflektojnë situatën që ishte e pranishme në vitin 2015. Duke pasur pesha fikse, indeksi është garantuar vetëm për të matur lëvizjet e çmimeve, që është qëllimi i indeksit.

Për të krahasuar indeksin e BE-së të paraqitur në këtë publikim me shtetet tjera, rekomandohet faqja elektronike e Eurostat-it (<http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/eurostat/home>).

### Llogaritja e indeksit elementar të çmimeve

Llogaritja e indeksit elementar është bërë në përgjithësi sipas formulave në vijim duke shfrytëzuar çmimet mesatare aritmetike të papeshuara.

$$R_i^t = \frac{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^t}{\frac{1}{n} \sum P_{ij}^0} \cdot 100$$

$R_i^t$  – Indeksi elementar për muajin t dhe prodhimin i

P – Çmimet e grumbulluara

i – Prodhimi i

j – Çmimi j i regjistruar për prodhimin (në përgjithësi çmimi për regjionin 1,2,...,n)

t – Muaji i vëzhguar

0 – Muaji bazë

**Llogaritja e indeksit të agreguar të çmimeve**

Llogaritja e indeksit të agreguar për totalin e prodhimeve ose nëngrupeve të indeksit të prodhimeve është bërë duke shfrytëzuar formulat në vijim.

$$I^t = \sum \left( R_i^t \cdot \frac{w_i^0}{\sum w_i^0} \right)$$

$I^t$	Indeksi i agreguar për periudhën t
$w_i^0$	Faktori peshues në periudhën bazë për prodhimin i
i	Prodhimi i
t	Muaji i vëzhguar
0	Muaji bazë

## Pyetëtori

DEFINICIONI -Përcaktimi i cakt (artikujve- vareteteve)

Numri i artikullit	Emri i artikullit			Sasia	Njësia
	Grumbulluesi i çmimit			Vendi i grumbullimit / Ndërmarrja	
Data					
Çmimi					

Shënimet e anketuesve

- Përshkrimi hollësishëm i artikullit (varietetit) specifik të zgjedhur për monitorim të çmimit
- Ndryshimet në përshkrimin e hollësishëm, data e ndryshimeve
- Trajtimi i ndryshimit të kualitetit kur përshkrimi është ndryshuar ( informacionet e vrojtimit të dyfishta të çmimit, plotësuese dhe vlerësimi i ndryshimit të kualitetit)

# Agjencia e statistikave të Kosovës

## *përshkrim i shkurtër*

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës** ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale. **Departamentet mbështetëse;** (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. **Në kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 155 punëtorë, prej tyre, 100 (68,0%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 47 (32,0%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 75,5% me shkollim universitar, 12,3 me shkollim të lartë, ndërsa 12,3% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikatat e shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**  
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129  
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [infoask@rks-gov.net](mailto:infoask@rks-gov.net)
- **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-gov.net>